

**STATUTI**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"TV JOHANITERI 2020" SHPK**

Në këtë statut :

- "Ligji" është Ligji 9901 Dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
- "Statuti " është Statuti i Shoqërisë.
- "Ditë të Plota " në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi .

**Kreu I**

**Themelimi ,Emri,Objekti,Kohezgjatja,Selia dhe Kontakti**

**Neni 1**

**Data e Themelimit ,Emri dhe Themeluesit**

Emri I Shoqerise eshte **" TV JOHANITERI 2020 " SHPK**

Forma e Shoqerise eshte ajo e Shoqerise me pergjegjesi te Kufizuar SH.P.K

Sipas nenit 68 te ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 Shoqeria **" TV JOHANITERI 2020 " SHPK**

nga Z. **Robert Xhaferri** , I biri i Maliq-it dhe Kene-s i datelndjes 23.07.1967 dhe Z.**Arjan Xhaferri** , I biri i Maliq-it dhe Kene-s I datelindjes 03.04.1977.

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

**Sherbim me televizion privat.**

**Neni 3**

**Kohezgjatja**

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj dhe operon si person juridik me personalitet të plote për të vepruar për një kohë të pacaktuar, mbi 10 vjet.

**Neni 4**


**Selia dhe Kontakti**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : **SHIJAK ,Lagjja Popullore, Rruga "Gani Keta", Zone Kadastrale 3369, Nr pasurie 102/1, Nr godine 5,kati pare.**

Numri Tel.Fax:

Numër Cel.:0682020291

email:jxhafa@gmail.com



**TV JOHANITERI 2020**

**LAGJJA POPULLORE**

**SHIJAK-DURRES**



**Kreu II**  
**Organet Drejtuese dhe kapitali i Regjistruar**

**Neni 5**  
**Organet Drejtuese**

Organet Drejtuese të shoqërisë **“TV JOHANITERI 2020 ” SHPK** janë:

- 1-Asambleja e Ortakeve dhe
- 2-Administratori

**Neni 6**

**Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë .Pjesmarja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij si mëposhtë:

► Ortake **Robert Xhaferri** , I biri i Maliq-it dhe Kene-s i datelndjes 23.07.1967 me nr Personal:G70723001T,lloji i kontributit para , vlera e kontributit 1 kuote me vlere **30.000 lekë** , Përqindja e zotërimit në kapitalin e shoqërisë 30 %

Dhe

► Ortake **Arjan Xhaferri** , I biri i Maliq-it dhe Kene-s i datelndjes 03.04.1977 me nr Personal:H70403016E : ,lloji i kontributit para , vlera e kontributit 1 kuote me vlere **70.000 lekë** , Përqindja e zotërimit në kapitalin e shoqërisë 70 %

Vlera totale e kapitalit të rregjistruar	<b>100.000 Lekë</b>
Vlera e paguar	<b>100.000 Lekë</b>

**Neni 7**

**Llojet e Kuotave ,të Drejtave dhe Kufizimeve**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese , kuotat mund të emëtohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblese se Ortakeve .

**Neni 8**

**Asambleja e Ortakeve** ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotat e zotëruara nga Ortaket e Shoqërisë .

Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkarisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave .në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit.Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës . Certifikatat nuk gëzojnë cilësinë e letrës me vlerë.



**TV JOHANITERI 2020**  
**LAGJJA POPULLORE**  
**SHIJAK-DURRES**



## Neni 9

### Kalimi me Kontratë i Kuotave

1. Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratori .Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.

2. Administratori mund të refuzojë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKR në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Administratori nuk bie dakort me personin të cilit i kalon kuota.

3. Nëse Administratori refuzon të regjistrojë kalimin e kuotës ,ai do të njoftojë për mospranimin personin të cilit i kalohen kuotat .Brënda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit te kuotës.

## Neni 10

### Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e falimentimit

1. Nëse nje nga Ortaket vdes ,trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave , dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve te kuotave ,do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij : pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti ,pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.

2. Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku,pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori ,mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfutues të kuotës .Nëse personi I mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës ,ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës ,ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.

3. Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të nje prej Ortakeve do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës ,duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës ,deri në momentin e regjistrimit në QKR.

## Neni 11

### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

1. Asambleja e Ortakeve ,mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat në shumën e përcaktuar në vendimin përkatë .Zmadhimi I Kapitalit me qëllim pranimit e ortakeve të rinj në shoqëri ,miratohet nga Asambleja e Ortakeve .

2. Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblese se Ortakeve.

## Neni 12

### Blerja e Kuotave te veta

Shoqëria mund te blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre ,jo nga fitimet e shoqërisë që do tu shpërndahen Ortakeve te shoqërisë apo emetimi I kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 te Ligjit dhe Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen .



TV JOHANITERI 2020  
LAGJJA POPULLORE  
SË JAJK-DURRES



Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit ,paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit.

### **Kreu III** **Asambleja e Ortakeve**

#### **Neni 13** **Asambleja e Ortakeve**

Asambleja e Ortakeve nëpërmjet vendimeve që merr ,realizon të gjithë veprimtarinë e shoqërisë .Ai përcakton drejtimit kryesore ,vendos për bilancin vjetor ,për ndryshimet në statut,për shtimin dhe zvogëlimin e kapitalit ,për pranimin në shoqëri të ortakëve të tjerë ,të gjitha këto në zbatim të ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

#### **Neni 13/1** **Te drejtat dhe detyrimet e Asamblese se ortakeve**

Ne baze te pikes 3 te nenit 81 te Ligjit Nr,9901 date 14/04/2008 Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- 1-Percaktimin e politikave tregtare te shoqërisë
- 2-Ndryshimet e statusit
- 3-Emerimin e shkarkimin e administratoreve
- 4-Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te Autorizuar
- 5-Percaktimin e shperblimeve per administratoret,likujduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar
- 6-Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret ,perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare dhe raporteve te ecurise se veprimtarise
- 7-Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- 8-Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit
- 9-Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- 10-Perfaqesimin e shoqërisë ne gjykate dhe procedime te tjera ndaj Administratoreve
- 11-Riorganizimin e prishjen e shoqërisë
- 12-Nisjen e nje hetimi te posacem per parregullsine pergjate veprimeve te themelimit te shoqërisë apo ushtrimit te veprimtarise tregtare,hetim i cili kryhet nga nje ekspert I pavarur I fushes.
- 13-Miraton Bilancin Vjetor,bilancin e konsoliduar,raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve dokumente keto te paraqitura nga administrator
- 14-Vendos per nisjen e proceduarve te likujdimit ne gjendjen e aftesive paguese ne perputhje me dispozitat e ligjit te ketij statute
- 15-Vendos per likujdimin me nje procedure te perjashtuar sipas statusit.



**TV JOHANITERI 2020**  
**LAGJJA POPULLORE**  
**SHIJAK-DURRES**



## Neni 14

### Thirrja e Asamblese se Ortakeve

1.Administratori thërret Asablene e Ortakeve .

## Kreu IV

### Administratori

## Neni 15

### Emërimi I Administratorit dhe afati I emerimit

1.Asambleja e Ortakeve zgjedh një ose më shumë persona fizikë .si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjecare.në pajtim me parashikimet e shkronjës "c"te pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit.Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë nga Asambleja e Ortakeve .I cili.nëse miratohet .sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

2.Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorit parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.

3.Personi e mëposhtëm caktohet si Administrator i Shoqërisë.

**Z. Arjan Xhaferri** , I biri i Maliq-it dhe Kene-s i datelndjes 03.04.1977 me nr

**Personal:H70403016E :**

**Per nje afat kohe prej 5 (pese ) vjetesh nga data : 18.01.2020 deri me 18.01.2025**

## Neni 16

### Kompetencat e Administratorit

1.Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratori .I cili mund të ushtrojë te gjithë kompetencat që nuk I rezervohen Asamblese se Ortakeve sipas nenit 81 te Ligjit .Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Ortakeve dhe udhezimet e Asamblese se Ortakeve nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorit .të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

2.Administratori mund t'ua delegojë kompetencat e tij cdo komiteti I cili përbëhet nga një ose më shumë Administratorë.Cdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosë Administratori dhe mund të revokohet ose ndryshohet.

3.Administratori lidh kontrata me persona fizik e juridik .shtetëror ose privat .vendas e të huaj sipas vendimeve që merr Asambleja e Ortakeve si dhe ndjek drejtimit e aktivitetit të shoqërisë .

Administratori ka të drejtë të emërojë perfaqësues të posacem cdo person të tretë për të kryer veprime në emër të tij për llogari të shoqërisë.

4-Perfaqeson shoqerine tregtare

5-Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave Kontabel te Shoqerise.

6-Te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor .bilancine konsoliduar.raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimit per shperndarjen e fitimeve

7-Te krijojë një system paralajmerimi ne kojen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarvajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.

8-Te kryej rregjistrimin dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise sipas Ligjit "Per Qendern kombetare te regjistrimit".

9-Te Raportoje perpara Asamblese se Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare .

10-Nese jane emeruar 2 ose me shume administrator ,keta e administrojne bashkarisht shoqerine.Asambleja e Ortakeve me vendim te vecante ,mund te percaktoje qe te kete rradhe hierarkike ne administrim ,nga administartoret e caktuar duke specifikuar rrethanat e kesaj perpariesi ndermejt administratoreve

11-Ne rast likujdimi ne gjendje e aftesise paguese,I njofton per rregjistrim QKR-se te dhenat e likujduesve te pare dhe tagrat e tyre..

#### **Neni 17**

##### **Skualifikimi dhe Shkarkimi I Administratorit**

Detyra e Administratorit përfundon në rast se :

- 1.Personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit .
- 2.Personi ndodhet në gjëndje pa aftësië paguese.
- 3.Personi vuan ose mund të vuajë nga erregullime mendore.
- 4.Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë.

#### **Neni 18**

##### **Shpërblimi ,Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit**

1.Administratorishpërblen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Ortakeve në përputhje me parashikimet e nenit 97 te Ligjit.

2.Asambleja e Ortakeve mund të parashikojë përfitime ,nëpërmjet shpërblimeve në para , pensione,sigurime ose forma të tjera ,për cdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri ,shoqëri të tjera ,të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose te filialeve të saj ,ose për cdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en) ose persona të cilet jane ose ishin në varësi të tyre ,dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla .

3.Administratorit mund ti paguhet të gjitha shpenzimet e udhëtimit ,akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tij në mbledhjet e Asamblese se Ortakeve ne lidhje me përmbushjet e detyrave të tij.

#### **Neni 19**

##### **Mbledhjet e Administratorit**

- 1.Mbledhjet e Administratorit do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.
- 2.Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorit ,pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e Administratorit ,do të konsiderohen të vlefshme njëjloj sikur ky person të ishte emëruar rregullisht dhe të ishte cilësuar e të vazhdonte detyrën si Administrator.

#### **Neni 20**

##### **Kufizimet në Votimet e Administratorit**

Administratori nuk do të lidhe marrëveshje për çështje në të cilat ky ka direkt ose indirekt ,një interes apo detyrim I cili është material ,që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë , në pajtim me nenin 13 teLigjit ,deri në momentin kur Asambleja e Ortakeve ka rënë dakort që:



TV JOHANITERI 2020

LACJJA POPULLORE

SHALL - DIBRES



1. Të autorizojë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe
  2. Të autorizojë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.
- Autorizimi mund të jetë I përgjithshëm ose I posacëm për një çështje të caktuar.  
Autorizimi I përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## **Neni 21**

### **Procesverbalet e Administratorit**

Administratori kujdeset që në libra të posacëm të mbahen procesverbalet e :

1. Të gjitha takimeve të kryera nga Administratori dhe
2. Të gjitha mbledhjeve të Asamblese së Ortakeve .

## **Kreu V**

### **Dividentët dhe Kalimi I Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

## **Neni 22**

### **Dividentët**

1. Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit ,shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblese së Ortakeve mund të deklarojë shpërndarjen e dividentëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat ,të gjithë dividentët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividenti .Të gjithë dividentët pjestohen dhe paguhet në përpjestim të drejtë me shumën e paguara për kuotat ,pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividenti ;në rast se kuota emëtohet me kushtin e përfitimit të dividentit nga një datë e caktuar ,dividenti do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

3. Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat e lidhen me kuotën.

4. Cdo divident që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit ,në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Ortakeve ,do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

## **Neni 23**

### **Kalimi I Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

Administratori ,pas vendimit të marrë nga Asambleja e Ortakeve ,duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit ,mund të vendosë të kalojë në kapitalin

themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividentët preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.



TV JOHANITERI 2020  
LAGJJA POPULLORE  
SHIRIAK-DURRES



**Kreu VI**  
**Prishja dhe njoftimet**

**Neni 24**  
**Prishja dhe likujdimi**

Në rast të likujdimit të shoqërisë, likujduesi në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblese së Ortakeve, mund të shpërndajë në dobi të Ortakeve të shoqërisë, të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim mund të vlerësojë çdo pasuri. Shoqëria përgjigjet vetëm me pasurinë e saj.

Ajo nuk përgjigjet për detyrimet që ortaku u merr përsipër si person fizik tej veprimtarisë së shoqërisë dhe nuk përballon personalisht humbjen e shoqërisë tej kontributit të kapitalit të vënë në shoqëri.

**Neni 24/1**  
**Emerimi i Likujduesit**

Likujduesi mer përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga adata e emerimit të tij. Kufizime të caktuara për veprimtarinë e likujduesit, mund të vendosen nga Asambleja e Ortakeve në aktin e emerimit të likujduesit. Këto kufizime publikohen në mënyrë elektornike sipas nenit 61 të Ligjit Nr 9723 për Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe kanë efekt ndaj të tretëve duke u quajtur i njohur publikisht në përputhje me nenin 12 të ligjit nr 9901.

Likujduesi ka për detyrë të ftojë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e shoqërisë.

Detyrimet kryesore të likujduesve janë:

- 1-Mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë
- 2-Mbledhja e kredive të paarketuara dhe kontributeve të pashlyera
- 3-Shitja e pasurisë së shoqërisë
- 4-Shlyerja e Kreditorëve duke respektuar radhën e preferimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil
- 5-Kryerja e veprimeve të reja tregtare në funksion të bmylljes së një veprimi të përfunduar.

Kur likujduesi vërejt se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e pretendimeve të ngritura nga kreditorët, likujduesi përsullon procedurën e likujdimit dhe i kërkon gjykatës nisjen e procedurave të falimentimit.

**Neni 25**  
**Njoftimet**

1.Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

2.Shoqëria mund të njoftojë Asamblesën e Ortakeve personalisht ose duke dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të Asamblese së Ortakeve ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që është njoftuar shoqërisë nga Asambleja e Ortakeve. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit.



**Kreu VII**  
**Dizpozitat e Fundit dhe Kalimtare**

**Neni 26**

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje  
**"TV JOHANITERI 2020" SHPK**  
**Lagjja Popullore**  
**Shijak-Durres**

**Neni 27**

Shoqëria është e detyruar të mbajë dokumentacionin kontabël ,librin e shoqërisë në të cilin shënohet emir I plotë I shoqërisë ,Asambleja e Ortakeve ,kapitali themeltar si dhe vendimet që merr Asambleja e Ortakeve .

Bilanci financiar mbyllet më 31 dhjetor të edo viti .Llogaritë vjetorë ,raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël miratohen nga Asambleja e Ortakeve . Miratimi I dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brënda një afati prej 6(gjashte) muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar .Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë për edo arsye .Për këtë Asambleja e Ortakeve vendos për mënyrën e likujdimt të saj ku caktohen një ose disa likujdatorë.

**Neni 28**

Të gjitha mos marëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimt do ti paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente.

**Neni 29**

Përsa nuk është parashikuar në këtë Statut ,I referohemi ligjit Nr.9901 Datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

**Neni 30**

Ky Statut është hartuar ne 4 kopje për tu administruar sipas Ligjit dhe hyn ne fuqi menjehere me rregjistrimin e tij prane QKR-se.

**Miratuar me Vendimin Asamblese se Ortakeve**

Z. Robert Xhaferri

Robert Xhaferri

TV JOHANITERI 2020  
LAGJJA POPULLORE  
SHIJAK-DURRES

Z. Arjan Xhaferri

ARJAN XHAFERRI

TV JOHANITERI 2020  
LAGJJA POPULLORE  
SHIJAK-DURRES